




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Podujevë
Nr. 05 -96
28/03/2019

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit shpall:

Konkurs për mësimdhënës

Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” Podujevë

- Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës (me plotësim të fondit të orëve në paralelen Orllanit)
 - me kohë të caktuar, deri më 30/06/2019

I. Kriteret e punësimit:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)
- Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi.

II. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Certifikatën që nuk është nën hetime,
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,

- Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018,
 - Intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet në shfmu “Shaban Shala” Podujevë, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 12.04.2019.

Drejtori
Agim Blakcori Msc.

